

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-zyrar  
Më 30.9.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për lejimin e mjeteve financiare, me qëllim të përkrahjes së manifestimit letrar, kulturor e shkencor "Takimet e Gjeçovit -2013, kryetari i Komunës më 30 shtator 2013, miratoi këtë:

V E N D I M  
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e mjeteve financiare me qëllim të përkrahjes së manifestimit të 42-të tradicional letrar, kulturor e shkencor të quajtur "Takimet e Gjeçovit -2013" që do të mbahet me 12 tetor 2013 në fshatin Zym të Hasit, kështu që lejohen mjetet në lartësi prej 2000 € në emër të përkrahjes financiare të manifestimit në fjalë.

Manifestimi organizohet nga Klubi letrar "Shtjefën Gjeçovi" nga Zymi në bashkëpunim me MKRS, MIE dhe me Drejtorinë për Kulturë, Rini e Sport.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.


Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

The image shows the official seal of the Municipality of Prizren, Kosovo, with the text "REPUBLIKA E KOSOVËS" and "KOMUNA E PRIZRENIT" around the perimeter. Overlaid on the seal is a handwritten signature in black ink, which appears to be "Ramadan Muja".